



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES  
MINISTRI

Nr. 1249 /  
prot.  
2

Tiranë, më 06.06. 2018

### UDHËZIM

Nr. 4, datë 06.06. 2018

### PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHTËPIVE TË PUSHIMIT TË USHTARAKËVE

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; në shkronjën “f”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në nenin 33, të ligjit nr. 9210, datë 23.03.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”:

### U DHË ZO J:

#### KREU I Të përgjithshme

##### 1. Qëllimi.

Qëllimi i këtij udhëzimi është rritja e cilësisë së shërbimit të shtëpive të pushimit në FA në dobi të përmirësimit, riaftësimit të vazhdueshëm të shëndetit të personelit që shërben në Forcat e Armatosura të RSH-së, duke krijuar kushte optimale dhe mundësi për çlodhjen pranë shtëpive të pushimit.

##### 2. E drejta për pushim në shtëpinë e pushimit të ushtarakëve.

- Ushtaraku aktiv (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist) i Forcave të Armatosura dhe familja e tij;
- Ushtaraku (oficer dhe nënoficer) në rezervë, në lirim ose në pension pleqërie, së bashku me familjen e tij;

- Punonjësit civilë në strukturat e Ministrisë të Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, së bashku me familjet e tyre;
- Veteranët e luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare;
- Civilët jashtë strukturave të Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes në rastet kur ka kapacitete të lira.

### **3. Parimet dhe përparësítë pér trajtimin e personelit.**

- Paanshmëri dhe transparencë në ofrimin e shërbimit pér pushime;
- Shanse të barabarta pér të gjithë personelin i cili ka të drejtë të pushojnë në shtëpitë e pushimit;
- Personat me aftësi të kufizuar dhe sëmundje të rëndë shëndetësore;
- Familjarët e ushtarakëve të rënë në krye të detyrës;
- Ushtarakët e kthyer nga misionet jashtë/brenda vendit;
- Personeli femër kryefamiljar në FA;
- Personat që nuk janë trajtuar me shtëpi pushimi më parë.

### **4. Fusha e zbatimit.**

Ky udhëzim zbatohet pér Shtëpitë e Pushimit të Ushtarakëve (SHPU) dhe është i detyrueshëm në të gjitha strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, strukturat vartëse të tyre, Komandat e Forcave dhe komandat mbështetëse.

### **5. Autoritetet, përgjegjësítë dhe strukturat:**

- a. Ministri i Mbrojtjes;
- b. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
- c. Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse;
- d. Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve;
- dh. Drejtoria e Buxhetit dhe Planifikimit Financiar;
- e. Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandeve;
- ë. Drejtoria e Personelit në SHP ( J-1);
- f. Inspektorati Shëndetësor;
- g. Batalioni i Mbështetjes në SHPFA;
- gj. Shtëpitë e Pushimit;
- h. Komandat e Forcave dhe komandat mbështetëse;
- i. Policia Ushtarake;
- j. Qendra e Kulturës, Medies, Botimeve dhe Muzeut;
- k. ASNI.

**a. Ministri i Mbrojtjes:**

- miraton udhëzimin për organizimin dhe funksionimin e shtëpive të pushimit të ushtarakëve;
- miraton urdhrin për caktimin e masës së pagesës në shtëpitë e pushimit;
- miraton planin e shpërndarjes së dhomave të shtëpive të pushimit;

**b. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së (SHPFA):**

- shqyrton dhe miraton kërkesat e paraqitura nga Batalioni i Mbështetjes për mbështetjen me mijete dhe personel, për funksionimin normal të shtëpive të pushimit të ushtarakëve;
- miraton rregulloren e brendshme, për administrimin dhe funksionimin e shtëpive të pushimit të ushtarakëve të hartuar dhe të propozuar nga Batalioni i Mbështetjes i SHPFA-së;
- kontrollon zbatimin e rregullave të administrimit dhe funksionimit të shtëpive të pushimit të ushtarakëve;
- propozon masën e pagesës për dhomat në shtëpitë të pushimit të ushtarakëve (Drejtoria e Logistikës J-4 në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit të Mbrojtjes J-5/8 dhe Batalionin e Mbështetjes) dhe e dërgon në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe shërbimeve;
- miraton autorizimet për personelin e Shtabit të Përgjithshëm dhe autonomet në varësi të tij për të pushuar në shtëpitë e pushimit të ushtarakëve gjatë sezonit veror;
- përfshin në listën e integruar të prioriteteve (LIP), projektet e investimeve të propozuara nga Batalioni i Mbështetjes, në kuadër të modernizimit dhe përmirësimeve infrastrukturore dhe akomoduese të shtëpive të pushimit.

**c. Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse:**

- përcakton objektivat dhe prioritetet, monitoron veprimtarinë e drejtorive të varësisë, siguron koordinimin e punës ndërmjet tyre dhe me njësitet e tjera të ministrisë për mirëadministrimin dhe funksionimin e shtëpive të pushimit të ushtarakëve;
- miraton propozimin e Batalionit të Mbështetjes në SHPFA, për ambientet të cilat mund të përdoren për shërbime bar-bufe dhe gatim, gjatë sezonit veror, si dhe operatorët ekonomikë të ofruar për kryerjen e këtyre shërbimeve.

**d. Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve:**

- ndjek procedurat e përgatitjes së udhëzimit për organizimin dhe funksionimin e shtëpive të pushimit të ushtarakëve;
- përgatit praktikën për ministrin e Mbrojtjes, për miratimin e masës së pagesës së dhomave në shtëpitë e pushimit të ushtarakëve të propozuar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së;
- në bashkëpunim me Drejtorinë e Personelit (J-1) në SHPFA, harton planin e shpërndarjes së dhomave të pushimit në SHPU-ve;
- administron dhe monitoron zbatimin e kërkesave të udhëzimit nga ana e strukturave, si dhe ndjek shpërndarjen e autorizimeve të nënshkruara nga ana e autoriteteve;
- administron dhe evidenton në vijimësi personelin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe autonomeve të saj, që është trajtuar me autorizim për të pushuar në SHPU.
- Jep autorizimet pas miratimit të listës emërore të pushuesve nga Drejtori i Kabinetit në Ministrinë e Mbrojtjes

**dh. Drejtoria e Buxhetit dhe Planifikimit Financiar:**

- bazuar në propozimin e shefit të SHPFA-së në LIP, i paraqet Grupit të Menaxhimit Strategjik të Ministrisë së Mbrojtjes propozimet për planifikimin e fondeve për investime, në kuadër të modernizimit dhe përmirësimeve infrastrukturore të shtëpive të pushimit;
- miraton planin e përdorimit të ardhurave të realizuara nga shtëpitë e pushimit, të propozuar nga Batalioni i Mbështetjes në PBA, për çdo vit buxhetor dhe përfshin kërkesat për përdorimin e të ardhurave në kërkesat buxhetore të Ministrisë së Mbrojtjes në PBA, për miratim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

**e. Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandeve:**

- Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandeve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, bazuar në udhëzimin e ministrit të Mbrojtjes nr. 3, datë 13.02.2015 “Për prokurimin publik në Ministrinë e Mbrojtjes, strukturat e varësisë dhe në Forcat e Armatosura”, prokuron mallra, punë dhe shërbime, për llogari të strukturave në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura, vlera e përllogaritur e të cilave gjatë një viti kalendarik/buxhetor, kalon kufirin prej 800.000 mijë lekë (pa t.v.sh.);
- strukturat e përcaktuara në pikën 5 të këtij udhëzimi, në funksion të mbarëvajtjes së funksionimit të shtëpive të pushimit, duhet të planifikojnë në kohë nevojat për punë mallra dhe shërbime, të hartojnë regjistrat e parashikimit në sistemin e prokurimit elektronik dhe të dërgojnë në Ministrinë e Mbrojtjes (Drejtorinë e Prokurimeve dhe Ankandeve), kërkesat për prokurim të përqendruar, bashkë me dokumentacionin shoqërues të nevojshëm për zhvillimin e procedurës;

- Në rast se nevojat e planifikuara përfshijnë mallra dhe shërbime, prokurimi i të cilave është përgjegjësi e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, kërkesat për prokurim të dërgohen pranë këtij institucioni, pas hartimit të regjistrat të parashikimit, brenda afateve të përcaktuara në udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

**ë. Drejtoria e Personelit në Shtabin Përgjithshëm të FA-së (J-1):**

- mbështet me personel shtëpitë e pushimit të ushtarakeve sipas kërkesës së bërë nga komandanti i Batalionit të Mbështetjes së SHPFA-së;
- në bashkëpunim me Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, harton planin e shpërndarjes së dhomave të pushimit në SHPU;
- administron dhe evidenton në vijimësi personelin e Shtabit të Përgjithshëm dhe të autonomeve në varësi të SHPFA-së që është trajtuar me autorizim për të pushuar në SHPU;
- administron dhe monitoron në bashkëpunim me DMBNJSH-në, zbatimin e kërkesave të udhëzimit nga ana e strukturave, si dhe ndjek shpërndarjen e autorizimeve të nënshkruara nga ana e autoriteteve.

**f. Inspektorati Shëndetësor në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së:**

- përgjigjet për dhënien e lejeve higjieno-sanitare të shfrytëzimit të ambienteve të shtëpive të pushimit të ushtarakeve, bazuar në ligjin nr. 7643, datë 2.12.1992 “Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror”;
- në bashkëpunim me Komandat e Forcave/Komanda Mbështetëse/Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes dhe Njësinë Mjekësore Ushtarakë merr masat dhe organizon mbështetjen mjekësore të pushuesve nëpërmjet shërbimit mjekësor roje 24-orësh me autoambulancë e personel mjekësor mjek dhe infirmier për trajtimin e urgjencave dhe rasteve të tjera që paraqiten pranë qendrës mjekësore, si dhe transportin e tyre në spitalin më të afërt kur kërkohet trajtim mjekësor më i avancuar;
- në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, personeli mjekësor në shtëpitë e pushimit të ushtarakeve, në bashkëpunim me personelin e SHPU-ve, kontrollon ushqimin e gatuar dhe në rast se e gjykon që ushqimi nuk është sipas kërkesave dhe kalorive të përcaktuara në marrëveshjen kontraktuale, bllokoni konsumimin e tij për pushuesit;
- në zbatim të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, personeli mjekësor në shtëpitë e pushimit, në bashkëpunim me SHPU-të, kontrollon produktet ushqimore në ruajtje dhe ushqimin e gatuar. Në rast se produktet ushqimore në depon e ushqimit apo në ambientin e gatimit nuk përbushin normat ligjore për konsum apo ushqimi i gatuar nuk është i freskët, është i papërshtatshëm për konsum njerëzor dhe gjyket i dëmshëm për shëndetin, bllokoni konsumimin e tij për pushuesit, njofton Inspektoratin Shëndetësor në SHPFA dhe dërgon mostrat për analizë në Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura;

- njofton Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU) për produktet ushqimore të blokuara.

**g. Batalioni i Mbështetjes së SHPFA-së:**

- i propozon shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së nevojat për mbështetjen me shërbime dhe personel shtesë për SHPU-të, gjatë periudhës së sezonit veror;
- të lidhë aktmarrëveshje për dhënien me qira të ambienteve të gatimit dhe pajisjeve për trajtimin me ushqim të gatuar të pushuesve gjatë sezonit të verës, sipas kritereve të VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”;
- në mbyllje të sezonit të pushimeve verore të informojë me shkrim Shtabin e Përgjithshëm dhe Ministrinë e Mbrojtjes, për shfrytëzimin e kapaciteteve, të ardhurat e realizuara, problematikat e hasura gjatë sezonit, si dhe propozimet për përmirësimë në të ardhmen;
- të planifikojë në kohë nevojat për investime e mallra, punime infrastrukturore, shërbime dhe të paraqesë kërkesën për përdorimin e të ardhurave gjatë hartimit të projektbuxhetit afatmesëm (PBA);
- të marrë masat për dezinfektimin, dizinsektizim dhe deratizimin e shtëpive të pushimit gjatë gjithë sezonit;
- informon me shkrim në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së (Drejtorinë e Personelit J-1) dhe Ministrinë e Mbrojtjes (Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse) për vënien në gatishmëri të shtëpive të pushimit të ushtarakëve, brenda muajit prill;
- të mbajë komunikim të vazhdueshëm me Qendrën e Bashkuar Operacionale gjatë periudhës së sezonit veror;
- të bëjë sigurimin me medikamente mjekësore sipas nevojave të shtëpive të pushimit të ushtarakëve;
- të kontrollojë në mënyrë periodike funksionimin dhe organizimin e SHPU-ve;
- të monitorojë zbatimin e kontratës me subjektin kontraktues dhe informon me shkrim Drejtorin e Përgjithshëm të Ekonomisë dhe Shërbimeve Mbështetëse;
- në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe të propozimit të shtëpive të pushimit të ushtarakëve, i propozojnë Ministrit të Mbrojtjes ambientet të cilat mund të shërbejnë për shërbime gatimi dhe bar-bufe, gjatë sezonit veror;
- personeli i SHPU-ve, të cilët punojnë me orare të zgjatura gjatë sezonit veror, të trajtohet në mbështetje të VKM-së nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”.

**gj. Shtëpitë e Pushimit të Ushtarakëve (SHPU):**

- të marrin masat për vënien në gatishmëri të shtëpive të pushimit të ushtarakëve, brenda datës 30 prill dhe informojnë me shkrim Batalionin e Mbështetjes të SHPFA-së;

- të krijojnë kushtet për akomodimin, çlodhjen dhe argëtimin e pushuesve sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren e shtëpive të pushimit të ushtarakëve;
- të realizojnë procesin e pritjes, pranimit, si dhe sistemimin e pushuesve sipas autorizimeve përkatëse;
- të arkëtojnë sipas rregullave pagesën e pushuesve, bazuar në autorizimet e pushuesve, dokument identifikimi;
- të mirëmbajë infrastrukturën e jashtme dhe të brendshme, zonën e plazhit, instalimet elektrike dhe hidraulike;
- të vendosin ambiente në dispozicion të personelit mbështetës të caktuar nga Komandat e Forcave dhe reparteve autonome, me urdhër të SHHPFA-së, gjatë sezonit të pushimeve verore;
- të zbatojnë rregullat e përcaktuara në rregulloren e brendshme të shtëpive të pushimit, rregulla të sigurisë, hyrje-daljeve dhe parkimit të automjeteve në SHPU;
- të mbajnë komunikim të vazhdueshëm me Batalionin e Mbështetjes, gjatë periudhës së sezonit veror;
- të afishojnë rregullat e brendshme në ambiente të dukshme për njohjen dhe zbatimin me rregulloren e shtëpive të pushimit;
- të bëjnë evidentimin dhe marrin masat për mirëmbajtje dhe riparime të nevojshme për SHPU-të, gjatë gjithë sezonit të pushimeve;
- të evidentojnë në regjistra të sekretuara pranimet dhe të ardhurat, të realizuara në sezonin veror dhe gjatë vitit mbi bazën e akteve ligjore, si dhe të raportojë çdo fillim dhe mbyllje dhjetëditori gjendjen dhe të ardhurat e përfituar;
- i propozojnë Batalionit të Mbështetjes në SHPFA ambientet të cilat mund të shërbejnë për shërbime gatimi dhe bar-bufe, gjatë sezonit veror, si dhe operatorët ekonomikë të ofruar për kryerjen e këtij shërbimi.

#### **h. Komandat e Forcave dhe atyre mbështetëse:**

- menaxhojnë dhe miratojnë shpërndarjen e autorizimeve të dhomave të pushimit për personelin e tyre;
- administrojnë dhe evidentojnë në vijimësi personelin që është trajtuar me shtëpi pushimi.
- mbështesin me personel mjekësor dhe autoambulancë, shtëpitë e pushimit të ushtarakëve për periudhën e sezonit veror;
- mbështesin shtëpitë e pushimit të ushtarakëve me personel mbështetës, kërkim-shpëtimi, mjete dhe pajisje (autobot uji, vetëshkarkuese, varka etj.), gjatë sezonit veror, sipas urdhrit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm;
- Komanda e Forcës Detare, në bashkëpunim me Batalionin e Mbështetjes në SHPFA, të marrë masat për ruajtjen dhe sigurinë e infrastrukturës të shtëpisë së pushimit të ushtarakëve në Durrës;
- të bëjnë furnizimin me karburant për mjetet dhe pajisjet e vëna në dispozicion të SHPU-ve gjatë sezonin veror;
- të trajtojnë me ushqim të gatuar personelin mbështetës në SHPU Durrës e Jalë;

- bazuar në konfirmimin e Batalionit të Mbështetjes në SHPFA, të bëjnë trajtimin financiar të personelit mjekësor roje 24-orë në mbështetje të shkronjës “gj”, pika 1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 15.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 11.08.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosura”, të ndryshuar;
  - Komanda Mbështetëse (Laboratori Qendror i FA-së) të ndjekë në vazhdimësi analizat biokimike të ujit të pijshëm dhe të detit në shtëpitë e pushimit të ushtarakëve.
- i. **Policia Ushtarake** të mbështesë me personel për zbatimin e rregullave të disiplinës gjatë sezonit veror në SHPU, Durrës e Jalë.
  - j. **Qendra e Kulturës, Medies, Botimeve dhe Muzeut**, sipas një programi të miratuar paraprakisht, të marrë masat për të zhvilluar aktivitete kulturore, artistike në shtëpitë e pushimit të ushtarakëve.
  - k. **Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit (ASNI)** të marrë masa për sigurimin e komunikimit në shtëpitë e pushimit të ushtarakëve.

## KREU II

### **Detyrimet dhe të drejtat e subjektit i cili do të marrë me kontratë qiraje ambientet.**

- a. Subjekti i cili do të marrë me kontratë qiraje ambientet, referuar VKM-së nr. 54, datë 05.02.2014 “Për dhënien me qira ose enfileozë të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”, për gatimin dhe/ose bar-bufe në shtëpitë e pushimit, do të lidhë aktmarrëveshje, sipas shkronjës “g”, pika 5, të kreut I të këtij udhëzimi;
- b. Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha shërbimet e kërkua, të mundësojë të gjithë artikujt ushqimore, sipas normave e kalorive përkatëse, të miratuar në VKM nr. 88, datë 28.01.2008 “Për trajtimin me ushqim të efektivave ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”;
- c. Në rast se Autoriteti Kontraktor nuk i siguron orënditë e pajisjet që nevojiten për gatim e shpërndarje, si dhe pajisje për ruajtje të zakonshme e frigoriferike, atëherë Kontraktuesi është i detyruar t'i sigurojë vetë;
- ç. Ambientet e shpërndarjes së ushqimit për funksionimin sa më normal të tyre do të mirëmbahen nga kontraktuesi, deri në përfundim të kontratës;
- d. Ambientet e gatimit të ushqimit, kuzhina dhe pajisjet në pronësi të Autoritetit Kontraktor, do t'i nënshtronen një kontrate qiraje sipas tarifave të përcaktuara në VKM-në nr. 54, datë

05.02.2014 “Për dhënen me qira ose enfiteozë të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”, ndërsa ambientet e servirjes së ushqimit, mensa dhe ambientet ndihmëse do të jepen në përdorim;

- dh. Kontraktuesi të disponojë mjete transportit të përshtatshme për transport të produkteve ushqimore, të cilat të plotësojnë kushtet higjeno-sanitare, sipas standardeve në fuqi. Automjetet të jenë të pajisura me certifikatë higjeno-sanitare, të lëshuar nga organet kompetente;
- e. Kontraktuesi duhet të lidhë konratë për furnizim me energji elektrike dhe ujë të pijshëm me institucionet përkatëse;
- ë. Kontraktuesi duhet të marrë masat për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve ushqimore në vendgrumbullimet e caktuara nga pushteti lokal;
- f. Mirëmbajtja e ambienteve të gatimit dhe të servirjes është përgjegjësi e kontraktuesit;
- g. Kontraktuesi duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor dhe SHPU-ve çdo 10 (dhjetë) ditë programin ushqimor, ku të përcaktojë menynë për çdo ditë dhe vakt ngrënje për pushuesit, e cila duhet të sigurojë sasinë, cilësinë dhe kaloritë e duhura. Sasia dhe cilësia e ushqimeve që furnizohen nga kontraktuesi duhet t'u përgjigjen kushteve që përcakton ligji nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”;
- gj. Kontraktuesi të plotësojë me pajisje të nevojshme ambientet e servirjes së ushqimit (mensën);
- h. Kontraktuesi dhe punonjësit duhet të zbatojnë rregullat e brendshme të Autoritetit Kontraktor;
- i. Personeli i kuzhinës dhe shpërndarjes së ushqimit duhet të jetë i kontrolluar për gjendjen shëndetësore dhe higjenike, duke i pajisur me librezën përkatëse shëndetësore;
- j. Produktet ushqimore që do hidhen për gatim, duhet të jenë të pajisura me fletë analize dhe me afat skadence;
- k. Furnizimi me lëndë të parë (produkte ushqimore), higjena e ambientit të kuzhinës dhe e personelit, do të kryhet në bazë të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”;
- l. Kontraktori duhet të mundësojë ushqim të sigurt, të freskët, të mbrojtur nga kontaminimet;
- ll. Të drejtën e kontrollit të cilësisë së ushqimit të gatuar, pastërtisë e ka mjeku së bashku me specialistin e Logistikës të SHPU-së, në prani të përfaqësuesit të Kontraktuesit;
- m. Mjeku dhe përgjegjësi i kuzhinës së Kontraktuesit, çdo vakt firmosin procesverbalin e ndërrimit të kampionit dhe librin e kontrollit cilësor të ushqimit për çdo gjellë të gatuar, si dhe të zbatojnë udhëzimin e MM-së nr.07, datë 04.07.2017 “Për procedurat dhe përgjegjësitë në ndjekjen, zbatimin dhe likuidimin e shërbimeve që realizohen nëpërmjet subjekteve kontraktore në FA”;
- n. Kontrolli i ushqimit bazohet në pamjen dhe kontrollin organo-leptik të ushqimit të përgatitur, ku shihet ngjyra, aroma, konsistenza, era dhe shija. Kontrollohet zbatimi i menysë, programit ushqimor, respektimi i çmimeve të vakteve të përcaktuara në urdhrin e ministrit të Mbrojtjes për tarifat. Gjithashtu, të drejtën e kontrollit e kanë dhe ekipe kontrolli të strukturave eprore të SHPU-ve me plane-kontrolli të miratuarë dhe në prezencë të përfaqësueseve të kontraktuesit;
- nj. Autoriteti kontraktor mund të ndërpresë aktmarrëveshjen në tërësi ose pjesërisht nëse:
  1. Kontraktuesi dështon në kryerjen e shërbimeve sipas kërkesave të kontratës së lidhur me Autoritetin Kontraktor;
  2. Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës;

3. Kontraktuesi pushon kryerjen e gatimit të ushqimit për një periudhe kohe prej 2 ditësh pa ndërprerje.
  
- o. Kontraktuesi duhet t'i japë Kontraktuesit njoftim me shkrim brenda një afati prej 15 ditësh me argumentet përkatëse për ndërprerjen e kontratës.

### **KREU III**

#### **Organizimi dhe funksionimi i shtëpive të pushimit të ushtarakëve**

##### **1. Rregulla të përgjithshme.**

- a. Në periudhën tetor- nëntor të çdo viti bëhet evidentimi i gjendjes së shtëpive të pushimit dhe planifikohen nevojat për riparim, mirëmbajtje, pastrim e sistemim ambientesh etj.;
- b. Masa e pagesës për të pushuar në shtëpitë e pushimeve të ushtarakëve miratohet nga ministri i Mbrojtjes, brenda datës 15 maj të çdo viti;
- c. Në muajin maj të çdo viti, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Personelit (J-1) në SHPFA, mbi bazën e numrit të personelit në FA, përgatisin për miratim planin e shpërndarjes së dhomave të shtëpive të pushimit;
- c. Shtëpitë e pushimit ofrojnë vetëm akomodim. Pushuesit janë të lirë të ushqehen pranë ambienteve në dispozicion të shtëpisë së pushimit kundrejt pagesës ndaj kontraktuesit ose jashtë ambienteve të saj. Nuk lejohet konsumimi/gatimi i ushqimit brenda dhomës/ambientit të akomodimit;
- d. Batalioni i Mbështetjes harton rregulloren e brendshme mbi funksionimin e shtëpive të pushimit dhe e dërgon për miratim te shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, brenda muajit maj;
- dh. Plani i shpërndarjes së dhomave të shtëpive të pushimit, i miratuar nga MM-ja, brenda datës 25 maj të çdo viti, u dërgohet strukturave;
- e. Pajisen me fletëhydrje provizore edhe automjetet e personelit pushues, nga Batalioni i Mbështetjes;
- ë. Vendosja e koshave të mbeturinave në plazh të bëhet në çdo 10 m dhe në vijë të drejtë;
- f. Pastrimi i ambienteve të jashtme në shtëpitë e pushimit dhe plazhe, sistemimi i çadrave, shezlloneve dhe koshave të mbeturinave të bëhen deri në orën 7:00, të çdo dite;
- g. Personeli mbështetës i vënë në dispozicion të shtëpive të pushimit të ushtarakëve zbaton urdhrat e drejtueseve të shtëpive të pushimit për kohën që janë në dispozicion të tyre;
- h. Strukturat e personelit në Ministrinë e Mbrojtjes, SHPFA, Komandat e Forcave dhe atyre mbështetëse verifikojnë kërkesat, kriteret dhe përgatisin për autoritetet përkatëse propozimet për trajtim me dhoma pushimi, si dhe mbajnë evidenca të sakta të personelit që trajtohet me dhoma pushimi;
- i. Personat e pajisur me autorizim duhet të konfirmojnë dy ditë më parë, përdorimin dhe shfrytëzimin e autorizimit për pushim, pranë strukturës përkatëse dhe struktura të marrë masa për zëvendësimin dhe të konfirmojë pranë shtëpive të pushimit shfrytëzimin e dhomave.

## **2. Dokumentacioni i nevojshëm.**

- a.** Personi për t'u pajisur me autorizim për të pushuar në shtëpitë e pushimit të ushtarakëve paraqesin pranë komandave, drejtive, dokumentet e mëposhtme:
  - kërkesë me shkrim, në të cilën parashtronhet identiteti i personit, statusi familjar (i/e martuar, beqar) dhe nëse është trajtuar vitin e mëparshëm;
  - fotokopjen e kartës së identitetit;
  - dokumentin që është familjar i personave që ka humbur jetën në krye të detyrës apo për shkak të saj.
- b.** Dokumentacioni që administrohet në shtëpitë e pushimit të ushtarakëve:
  - autorizimi nga autoritetet përkatëse për dhënie dhoma për pushim;
  - karta e identitetit e personit që disponon autorizimin.
- c.** Dokumentacioni që administrohet, në rast se ka dhoma të lira të paplotësuara me pushues të autorizuar:
  - kartë identiteti;
  - fletëhydrje që vërteton që është personel i strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura (në rast se është personel i tyre).

## **3. Kriteret dhe rregullat përfunksionimin e shtëpive të pushimit të ushtarakëve.**

- a.** Shtëpitë e pushimit të ushtarakëve në Durrës dhe Jalë, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, të vihen në dispozicion të pushuesve për periudhën 1 qershor deri në 30 shtator për çdo vit kalendarik;
- b.** Shtëpitë e pushimit të ushtarakëve në Pogradec e Vlorë të vihen në dispozicion të pushuesve gjatë gjithë vitit;
- c.** Shtëpitë e pushimit të ushtarakëve në Durrës dhe Jalë të shërbjnë si hoteleri në masën 50% të kapaciteteve akomoduese për periudhën jashtë sezonit të pushimeve;
- ç.** Kohëzgjatja për çdo sezon pushimi në shtëpitë e pushimit të ushtarakëve në Durrës dhe Jalë, të jetë 10 ditë kalendarike gjatë sezonit veror. Pranimi i pushuesve të bëhet në datat 1, 11, dhe 21 të çdo muaj;
- d.** Kohëzgjatja për pushim në Shtëpitë e Pushimit të Ushtarakëve në Pogradec dhe Vlorë të jetë ditore, por jo më shume se 10 ditë;
- dh.** Kohëzgjatja për pushim në Shtëpitë e pushimit të ushtarakëve në Durrës dhe Jalë jashtë sezonit veror të jetë ditore;

- e. Në shtëpitë e pushimit të ushtarakëve në Durrës dhe Jalë, të planifikohen për të pushuar ushtarakët aktivë, në rezervë, në lirim e në pension, veteranët dhe civilët që janë personel i strukturave të Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes, së bashku me familjet e tyre;
- ë. Në shtëpitë e pushimit të ushtarakëve, Pogradec, Vlorë të planifikohen për të pushuar ushtarakët aktivë dhe civilë të strukturave të Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes, së bashku me familjet e tyre;
- f. Në rastet kur në shtëpitë e pushimit të ushtarakëve mbeten vende bosh pas sistemimit të personelit të pajisur me autorizime, të sistemohen nga përgjegjësit e shtëpive të pushimit të ushtarakëve, pjesëtarë të Forcave të Armatosura, të cilët nuk disponojnë autorizim ose civilë jashtë strukturave të Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes, kundrejt masës së pagesës të përcaktuar në urdhrin e ministrit të Mbrojtjes;
- g. Plani i shpërndarjes së dhomave për personelin pushues në shtëpitë e pushimit të ushtarakëve në Durrës dhe Jalë, për secilën strukturë organike të bëhet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në Ministrinë e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Drejtorinë e Personelit (J-1) në Shtabin e Përgjithshëm dhe të miratohet nga ministri i Mbrojtjes;
- gj. Miratimi i autorizimeve për personelin e Ministrisë së Mbrojtjes, autonomeve të saj, ushtarakët në rezervë, në lirim e në pension, si dhe veteranëve të LANÇ-it, të cilët do të pushojnë në shtëpinë e pushimit të ushtarakëve në Durrës, Jalë, gjatë sezonit veror, të bëhet nga Drejtori i Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në Ministrinë e Mbrojtjes, në fillim të çdo muaji, pas marrjes së miratimit për listën e pushuesve nga Drejtori i Kabinetit të Ministrit;
- h. Miratimi i autorizimeve për personelin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, dhe autonomeve të saj, të cilët do të pushojnë në shtëpinë e pushimit të ushtarakëve Durrës dhe Jalë, gjatë sezonit veror të bëhet nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm ose nga personi i autorizuar prej tij, me propozim të Drejtorisë së Personelit (J-1) në SHPFA në fillim të çdo muaji, duke raportuar paraprakisht listën e pushuesve tek Drejtori i Kabinetit të Ministrit;
- i. Miratimi i autorizimeve për të pushuar në shtëpitë e pushimit në Durrës dhe Jalë gjatë sezonit veror, për personelin e Forcave dhe Komandave Mbështetëse, KDS, bëhet nga komandantët e forcave/mbështetëse në fillim të çdo muaji, duke raportuar paraprakisht listën e pushuesve tek Drejtori i Kabinetit të Ministrit;
- j. Miratimi i autorizimeve për të pushuar në shtëpitë e pushimit në Vlorë dhe Pogradec të behet nga Drejtori i Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve;
- k. Miratimi i autorizimeve për të pushuar në shtëpitë e pushimit në Durrës dhe Jalë, jashtë sezonit veror për individ dhe familjet, të bëhet nga përgjegjësit e shtëpive të pushimit;
- l. Miratimi i autorizimeve për të pushuar në shtëpitë e pushimit në Durrës dhe Jalë, jashtë sezonit për grupe dhe kolektive, të bëhet nga Drejtori i Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në Ministrinë e Mbrojtjes, pas marrjes së miratimit për listën e pushuesve nga Drejtori i Kabinetit të Ministrit.

#### **4. Tarifat e dhomave të shtëpive të pushimit.**

- a. Masa e pagesës së dhomave të shtëpive të pushimit të ushtarakëve të përcaktohet me urdhrin e ministrit të Mbrojtjes për çdo vit.

- b. Masa e pagesës së dhomave në shtëpitë e pushimit të ushtarakëve, për civilët jashtë Forcave të Armatosura, në rastet kur ka kapacitete të lira, të jetë 50% më e lartë se masa e pagesës së përcaktuar sipas tarifave të përcaktuara në urdhrin e ministrit të Mbrojtjes.
- c. Masa e pagesës së dhomave në shtëpitë e pushimit të ushtarakëve, në rastet kur ka kapacitete të lira për punonjësit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, të cilët nuk kanë autorizim të jetë e njëjtë si në rastet e paraqitur me autorizim.
- ç. Masa e pagesës për familjarët e rënë në krye të detyrës të jetë 50% më e ulët se masa e pagesës e përcaktuar në urdhrin e ministrit të Mbrojtjes.

## 5. Sanksionet.

- Shkelja e dispozitave të këtij udhëzimi përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore dhe marrjen e masave përkatëse disiplinore dhe administrative. Masat disiplinore dhe administrative jepen nga autoritetet përkatëse, në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- Mospërbushja e detyimeve të kontratës nga ana e Kontraktorit përbën shkak për prishjen e kontratës dhe aplikimin e saknksioneve të përcaktuara në të.
- 6. Përgjigjen për zbatimin e këtij udhëzimi strukturat e përmendura në këtë udhëzim.
- 7. Ndjek zbatimin e këtij udhëzimi sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

